

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 6 prot.

Tiranë 23.03.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik Florian Ballhysa kundër vendimit nr.02, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Adriatik Llalla.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 i Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, në datë 08.03.2018 është njoftuar Vendimi nr.02 datë 16.02.2018, me numër 9 Akti, nr.2403 prot., i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin në rivlerësim z. Adriatik Llalla, ish Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C pika 2, Neni F pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63 pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15 ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj Vendimit nr.02 datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit profesional, shtojca 4 e ligjit nr.84/2016, rezulton se z. Adriatik Llalla ushtron funksionin e prokurorit nga muaji janar 1999. Emërimi i z Adriatik Llalla në funksionin e prokurorit, bazuar në nenin 149/3 të Kushtetutës, është bërë nga Presidenti i Republikës, me dekretin nr.2298, datë 15.01.1999. Subjekti i rivlerësimit z. Adriatik Llalla në formularin e mësipërm në lidhje me funksionet që ka kryer ndër vite, ka vetëdeklaruar si vijon:


- i) në periudhën 01/1999-04/2003 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë,
- ii) në periudhën 05/2003-12/2004 prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier,
- iii) në periudhën 12/2004-01/2008 prokuror/zv.drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë,
- iv) në periudhën 01/2008-10/2008 prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë,
- v) në periudhën 10/2008-12/2012 Inspektor i Përgjithshëm i ILDKPKI,
- vi) në periudhën 12/2012-12/2017 Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë.

2. Ndaj subjektit të rivlerësimit z. Adriatik Llalla, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 4 pika 4 e ligjit nr.84/2016, ka nisur procedurën e rivlerësimit kalimtar me përparësi në kohë mbi bazën e shortit të hedhur në datë 06.11.2017.

3. Gjatë ecurisë së procesit të rivlerësimit, mandati i subjektit z Adriatik Llalla si Prokuror i Përgjithshëm ka përfunduar në datë 18.12.2017, materializuar me vendimin e Kuvendit nr.115/2017 “Për caktimin e prokurorit që do të kryejë përkohësisht detyrën dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm”¹.

4. Në datë 24.01.2018 (protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.847 prot.), subjekti z Adriatik Llalla i drejtohet me shkresë informuese titullarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku i parashtron se: “...duke qënë se mandati im si Prokuror i Përgjithshëm ka përfunduar në datë 18.12.2017, unë nuk konsiderohem më subjekt

¹ Vendimi i Kuvendit është botuar në FZ nr.222, datë 19.12.2017.




rivlerësimi, aq më tepër subjekt prioritar për t'ju nënshtruar rivlerësimin sipas ligjit të mësipërm...".

5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me anë të shkresës nr.1295 prot, datë 01.02.2018, i ka kthyer përgjigje subjektit z Adriatik Llalla duke parashtruar: *"...ju orientojmë se...sa i përket ndërprerjes së procedurave të rivlerësimin...përfundimi i mandatit Tuaj si Prokuror i Përgjithshëm nuk lidhet me përfundimin e statusit Tuaj si magjistrat apo si person që keni ushtruar atë funksion, çka bën që të vijoni ta gëzoni ende statusin. Neni 148/a, paragrafi 5 i Kushtetutës parashikon për këtë status se "Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në gjykatën e apelit...Ju keni qenë magjistrat/prokuror në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në momentin e hyrjes në fuqi të ligjeve të reja të paketës së Reformës në Drejtësi..."*

6. Në datë 10.02.2018, subjekti i drejtohet Presidentit të Republikës (protokolluar me nr.381 prot, dt.12.02.2018 pranë institucionit të Presidencës) me kërkesë dorëheqjeje, ku ndër të tjera deklaron se *"Neni 61 i ligjit nr.96/2016 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, parashikon se me mbarimin e mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, ai ka të drejtë që të caktohet në një pozicion në nivel apeli. Në aplikim të nenit 56 të Ligjit Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në RSh dhe vendimit nr.79 viti 2017 të Gjykatës Kushtetuese të RSH, ku parashikohet e drejta për të hequr dorë në cdo kohë nga funksioni i magjistratit deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar nga KPK, Ju paraqes dorëheqjen time nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta që më njeh ligji për tu emëruar në një pozicion në nivel apeli".*

7. Institucioni i Presidentit të Republikës me anë të shkresës nr.381/1 prot., të datës 12.02.2018, (protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr.1795 prot., datë 12.02.2018) ia dërgon kërkesën e mësipërme për dorëheqje të subjektit, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në shkresën e mësipërme të Presidencës parashtrohet: *"...po ju dërgojmë kopje origjinale të kërkesës për dorëheqje të z.Adriatik Llalla nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta që i njeh ligji për t'u emëruar në një pozicion në Gjykatën e Apelit".*

8. Subjekti z Adriatik Llalla në vijim të përgjigjes që i është kthyer nga Komisioni i Pavarur i Apelit në datë 01.02.2018, i ridrejtohet më një kërkesë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datë 12.02.2018 (protokolluar me nr.1737 prot pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit) ku parashtron se: *"...në përgjigjen Tuaj më njoftoni se vazhdoj përsëri të jem subjekt i rivlerësimin kalimtar pasi kam ende të drejtë të pretendoj të emërohem në një pozicion apeli. Me këtë shkresë ju informoj se me shkresën time të datës 10.02.2018 drejtuar Presidentit të Republikës, kam paraqitur dorëheqjen time nga e drejta që më njeh ligji për tu*



caktuar në një pozicion apeli. Neni 61 i ligjit nr.96/2016 parashikon se personat e listuar në pikën 1 të këtij neni, përfshirë edhe Prokurorin e Përgjithshëm, kanë të drejtë që pas mbarimit të mandatit të caktohen në një pozicion apeli. Neni 56 i ligjit nr.84/2016 parashikon dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit dhe detyrimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të ndërprerë procedurën. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. Me vendimin nr.78/2017 GjK ka vendosur në pikën nr.43 të këtij vendimi shprehimisht nënvizohet: Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte Ju bëj me dije se kam hequr dorë nga statusi i magjistratit dhe nga e drejta për tu emëruar në një pozicion apeli, prandaj Ju lutem të zbatoni detyrimin tuaj ligjor dhe kushtetues duke marrë vendim për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit”.

9. Rezulton se mbi këtë bazë dokumentash, në lidhje me dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla, trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka vijuar procedurat për vendimmarrje.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

10. Nga procesverbalet përkatës të administruar, trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e ka shqyrtuar çështjen mbi bazë dokumentesh, në prani të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.


11. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.02, datë 16.02.2018 ka vendosur:

“-Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, Z Adriatik Xhemal Llalla, është ndërprerë.

-Ky vendim u njoftohet: subjektit të rivlerësimit, Z. Adriatik Xhemal Llalla, Komisionerit Publik dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

11.1 Nga përmbajtja e vendimit, rezulton se pjesa urdhëruese e tij (dispozitivi) bazohet në arsyetimin se me përfundimin e mandatit të subjektit të rivlerësimit si Prokuror i Përgjithshëm, datë 18.12.2017, në bazë të nenit 148/a, pika 5 e Kushtetutës, ai emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në Gjykatën e Apelit vetëm me kërkesë të tij, e në këto kushte pavarësisht përfundimit të mandatit të tij kushtetues, procesi i rivlerësimit ndaj tij ka vazhduar,



pasi Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vlerëson se e vetmja mënyrë për ndërprerjen e këtij procesi që parashikon legjislacioni shqiptar është dorëheqja (fq.4 e vendimit);

11.2 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konstaton se është vënë në dijeni të kërkesës për dorëheqje të subjektit “nga funksionet e magjistratit dhe nga e drejta për tu caktuar në një pozicion Apeli”, nga kërkesa drejtuar Presidenit të Republikës, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr.1737 prot, datë 12.2.2018.

11.3 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në pjesën arsyetuese të vendimit ka vlerësuar se ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, ai humbet të drejtën për t’ u emëruar *gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit “G” të Aneksit të Kushtetutës.*;


11.4 Arsyetimi i mësipërm rezulton të jetë mbështetur dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht Vendimi nr.78, datë 12.12.2017 i kësaj gjykatë, paragrafi 43, ku interpretohet harmonizimi i dispozitës së nenit G të Aneksit të Kushtetutës me nenin 56 të ligjit nr.84/2016: “[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.”

III. Shkaqet e ankimit.

III.A

12. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në raport me ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit, do të duhej të argumentonte në mënyrë shteruese natyrën specifike të statusit të subjektit konkret të rivlerësimit, bazuar në administrimin e plotë të akteve dhe dokumentacionit që lidhen me dorëheqjen e paraqitur nga subjekti konkret i rivlerësimit, efektet ligjore *shkak-pasojë* të paraqitjes së dorëheqjes, pasi në gjendjen që janë aktet konstatohet se dorëheqja paraqitet vetëm në formën e shprehjes së njëanshëm të vullnetit të subjektit të rivlerësimit.

13. Nisur nga arsyetimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe akteve të administruara prej tij, nuk rezulton të jetë identifikuar dhe për rrjedhojë të jetë argumentuar



zbatimi në rastin konkret i dispozitave kushtetuese dhe ligjore, organit kushtetuese që është kompetent, si dhe procedurave, për administrimin e kërkesës dhe vendimmarrjen përkatëse, në rastet e ushtrimit të së drejtës së dorëheqjes nga statusi i magjistratit, rrethana juridike këto, verifikimi i të cilave do të mundësonte urdhërimin nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të zbatimit të dispozitës së nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

14. Në mbështetje të argumentit të mësipërm, fillimisht do të duhej që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të analizonte momentin e emërimit të subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit dhe vijimin e gëzimit të tij në raport me mbarimin e mandatit si Prokuror i Përgjithshëm, duke identifikuar kështu rregullimin ligjor përkatës.


14.1 Referuar provave të administruara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë procesit të rivlerësimit për këtë subjekt, rezulton se nga përmbajtja e Shtojcës 4 të ligjit nr.84/2016 “*Formulari i vetëvlerësimit profesional*”, subjekti ka ushtruar funksionin e prokurorit, duke gëzuar dhe statusin përkatës, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, Fier dhe Tiranë, prej vitit 1999 deri në vitin 2008.

14.2 Në vitin 2008, Presidenti i Republikës, me dekretin e datës 14 korrik 2008, i ka propozuar Kuvendit të Shqipërisë, si kandidaturë alternative, zgjedhjen e subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP). Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr.219, datë 9 tetor 2008 e ka zgjedhur subjektin e rivlerësimit z Adriatik Llalla në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm.

14.3 Gjatë kësaj periudhe, 1999-2008, subjekti i rivlerësimit z Adriatik Llalla ka gëzuar statusin e prokurorit, referuar ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e RSH (nenet 148-149), i ndryshuar dhe ligjit të kohës nr.8734, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH²”, i ndryshuar, neni 1 germa “c” dhe kreu VIII “Statusi dhe karriera e prokurorit”.

14.4 Rezulton se edhe pas zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të detyrës së Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP, në periudhën 10/2008-12/2012 subjekti i rivlerësimit z Adriatik Llalla, në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit, në vlerësimin tonë, ka vijuar ta gëzojë statusin e prokurorit.

² Ndryshuar me V-GjK nr.25/2002, Ligjin nr.9102, datë 10.7.2003 dhe me ligjin nr.10051, datë 29.12.2008.



14.5 Ligji organik i prokurorisë i lartpërmendur, referuar dispozitave përkatëse të Kushtetutës, parashikon se funksioni i prokurorit përfundon në rastin e *largimit nga detyra* (jep dorëheqjen, mbush moshën 65 vjeç) dhe *shkarkimit nga detyra* (si masë disiplinore);


14.6 Ndërkohë, edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë³ kanë njësuar praktikën gjyqësore duke marrë në shqyrtim natyrën e dekretit të Presidentit të Republikës në krijimin, ndryshimin dhe shuarja e marrëdhënieve të shërbimit publik të një kategorie funksionarësh të rëndësishëm të shtetit ku përfshihen edhe prokurorët. Në vendimin unifikues nr. 3, datë 30.01.2003 (civil), Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë se: *“Marrëdhëniet e ketyre personave me shtetin për kryerjen e detyrave të caktuara bazohen jo në një kontratë të thjeshtë pune, por në një kontratë të veçantë të shërbimit publik, nëpërmjet të cilës ata marrin përgjegjësi të vecante për mbrojtjen e interesave të larta publike, në të cilat mishërohet vetë sovraniteti i shtetit. Si të tilla, ato bazohen jo vetëm në profesionalizmin, por edhe në një shkallë të lartë besimi dhe bështetje ndaj shtetit. Është kjo arsyeja që lidhja, ndryshimi apo mbarimi i kësaj kontrate shërbimi publik, nuk formalizohet me një akt të zakonshëm të një organi të administratës publike (akt administrativ), por me dekret të Presidentit të Republikës. Nisur nga sa më lart, është në diskrecionin e shtetit, të mishëruar në Dekretin e Presidentit jo vetëm krijimi, por edhe ndryshimi apo shuarja e marrëdhënieve të shërbimit publik të një karakteri të tillë...Në këtë kategori funksionarësh të rëndësishëm të shtetit janë përfshirë edhe prokurorët e të gjitha niveleve. Kjo rezulton prej neneve 148, 149 të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë. “*

14.7 Nuk rezulton që për subjektin konkret të rivlerësimit z. Adriatik Llalla, pas zgjedhjes në detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP në tetor 2008 të ketë dalë një dekret i Presidentit të Republikës që ka disponuar për largimin e tij nga funksioni i prokurorit, për një nga shkaqet e parashikuara në ligj (*eventualisht dorëheqje*).

14.8 Vlen për t’u nënvizuar se dhe në mbështetje të dispozitës materiale përkatëse që trajton mbarimin e mandatit si Inspektor i Përgjithshëm i ILDKP, subjektit të rivlerësimit i lindte e drejta që me pëlqimin e tij të emërohej në funksionin ose detyrën publike (pra atë të prokurorit), që kishte para zgjedhjes së tij ose në një vend të barazvlefshëm me vendin e mëparshëm (neni 11, pika 5, ligji 9049/2003 i ndryshuar);

14.9 Në referencë të kësaj analize sistematike kushtetuese dhe ligjore, rezulton se për subjektin e rivlerësimit z. Adriatik Llalla ka dekret emërimi në funksionin e prokurorit nga Presidenti i Republikës, por nuk ka dekret për largim/shkarkim nga funksioni. Kështu që, në

³ Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.3, datë 30.1.2003 (civil)



vlerësimin tone, subjekti i rivlerësimit z Adriatik Llalla vijon të gëzojë statusin e magjistratit/prokuror për shkak të funksionit të ushtruar para vitit 2008.

14.10 Ndërkohë, Presidenti i Republikës me dekretin nr.7840, datë 3.12.2012, i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë për dhënie pëlqimi, emërimin e subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, bazuar në nenin 149, pika 1 të Kushtetutës e ndryshuar. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr.49/2012⁴ ka dhënë pëlqimin për emërimin e subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla si Prokuror i Përgjithshëm.

15. Duke iu referuar situatës kushtetuese dhe ligjore që ka konstatuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në lidhje me mbarimin e mandatit si Prokuror i Përgjithshëm, në vijim do të analizohet se çfarë pasojash sjell edhe mbarimi i mandatit në raport me statusin (magjistrat) të subjektit në këtë rast si ish Prokuror i Përgjithshëm i Republikës.


15.1 Mbarimi i mandatit të subjektit si Prokuror i Përgjithshëm nuk ndikon në vijimin e gëzimit të statusit si magjistrat/prokuror, pasi para përfundimit të mandatit të subjektit të rivlerësimit (18 dhjetor 2017), kishin hyrë në fuqi ndryshimet kushtetuese dhe ligji nr.96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në RSH, i ndryshuar”.

15.2 Ligji 96/2016 jep kuptimin e magjistratit në nenin 2 gërma “gj” ku përfshin gjyqtar, prokuror, kryetarët e gjykatës apo prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe kryetarin e Gjykatës së Lartë. Ky status i magjistratit gëzohet nga të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit 96/2016 (datë 22 nëntor 2016) me kushtin e kalimit të procesit të rivlerësimit (neni 164 pika 1);

15.3 Subjekti përfitoi *ipso lege* nga dispozita e pikës 10 të nenit 179 të Kushtetutës dhe nga dispozita kalimtare e ligjit nr.96/2016, neni 164/b, i cili shprehet se “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar kësaj dispozite, ligjvënësi i ka njohur subjektit për shkak të funksionit prokuror në detyrë, statusin e magjistratit, vijueshmëria e të cilit varej nga kalimi apo jo i procesit të rivlerësimit kalimtar.

15.4 Duke pasur statusin e magjistratit e rrjedhimisht duke gëzuar të drejtat që garantonte ky status për subjektin, me të drejtë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në shkresën e datës 01.02.2018 i sjell në vëmendje subjektit konkret të rivlerësimit se: “...përfundimi i mandatit tuaj si Prokuror i Përgjithshëm, nuk lidhet me përfundimin e statusit tuaj si magjistrat apo si

⁴ Botuar në FZ nr.162, datë 19.12.2012



person që keni ushtruar atë funksion, ç'ka ju bën që të vijoni dhe ta gëzoni ende statusin"... Ju keni qenë magjistrat/prokuror në detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në momentin e hyrjes në fuqi të ligjeve të reja të paketës së Reformës në Drejtësi...".

15.5 Në vijim të kësaj analize, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e ka orientuar subjektin e rivlerësimit se ndërprerja e procesit të rivlerësimit mund të bëhet vetëm në kushtet e parashikuara nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, pra kur subjekti i rivlerësimit jepte dorëheqjen.


15.6 Por nisur nga përmbajtja e vendimit nr.02, datë 16.02.2018, në vijim të procedurave përkatëse, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk ka hetuar në lidhje me përmbushjen ose jo të procedurave të parashikuara në ligj për deklarimin e heqjes dorë te subjektit të rivlerësimit nga statusi i magjistratit, me qëllim ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar.

15.7 Dhënia e dorëheqjes nga detyra në kuptim të nenit G të Kushtetutës sjell pasoja si në ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, ashtu edhe në ndalimin e emërimit si gjyqtar, prokuror, Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Prokuror i Përgjithshëm apo anëtar i KLGJ-s apo KLP-s, për një periudhë 15 vjeçare. Dispozita kushtetuese *hesht* në lidhje me aspekte procedurale të dhënies/pranimit të dorëheqjes dhe rolit që luajnë organet përkatëse në këtë procedurë. Kjo *heshtje* i përshtatet natyrës së Kushtetutës, si dokumenti themeltar i një shteti, që nuk merr përsipër të rregullojë gjithçka, por vendos kornizat e përgjithshme, mbi bazën e të cilave ligji derivon në parashikime specifike, sic janë në rastin konkret dispozitat e ligjit 84/2016 dhe ligjit 96/2016.

15.8 Dhënia e dorëheqjes nga detyra në kuptim të nenit 56 të ligjit 84/2016 brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit sjell si pasojë *pushimin e procedurës së rivlerësimit* edhe të drejtën e pagesës kalimtare të subjektit të rivlerësimit sipas legjislacionit në fuqi për përfitimet sociale (pensione). Aspekte procedurale të dorëheqjes janë të detajuara në pikën 1 të nenit 56, lidhur me organin të cilit i paraqitet me shkrim është Presidenti i Republikës dhe publikimit në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

15.9 Dhënia e dorëheqjes nga detyra në kuptim të ligjit 96/2016 gjen rregullim si në regjimin ligjor në situatë normaliteti ashtu edhe në periudhën kalimtare deri në ngritjen e organeve të drejtësisë (Këshilli i Lartë Gyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë). Dispozitat e ligjit 96/2016, sipas përcaktimit të nenit 169, zbatohen menjëherë me hyrjen në fuqi të ligjit përse i përket të drejtave dhe detyrave të magjistratit, ndaj dhe paraqet interes për çështjen trajtimi i rregullimeve ligjore në të dyja momentet (regjimi ligjor në normalitet dhe regjimi ligjor në periudhë kalimtare):

15.9.1 Dispozitat procedurale dhe materiale të dorëheqjes së magjistratëve i gjejmë në nenin 65 të ligjit sipas të cilit, magjistrati e paraqet dorëheqjen para Këshillit përkatës



(neni 65 pika 1, Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë). Dhënia e dorëheqjes sjell si pasojë deklarimin me vendim të mbarimit të statusit të magjistratit nga këshilli (neni 65 pika 2) dhe pasqyrimin në dosjen personale të magjistratit që krijohet dhe administrohet nga Këshillat (neni 38 pika 1 dhe 2 "f").

15.9.2 Dispozitat procedurale dhe materiale të dorëheqjes në periudhën kalimtare deri në konstituimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurisë i gjejmë në nenin 160 të ligjit 96/2016, ku parashikohen organet kompetente për periudhën kalimtare dhe kompetencat që ato kanë.

15.9.3 -Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor "...Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të vazhdojë të ushtrojë disa kompetenca sipas rregullave të ligjit 96/2016 ku ndërmjet të tjera vërteton ndërprerjen e emërimit, në rast dorëheqje ... (neni 160, pika 1 "ë");


15.9.4 -Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë "...Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë disa kompetenca sipas rregullave të ligjit 96/2016 ku ndërmjet të tjera vërteton mbarimin (ndërprerjen) e emërimit në rast dorëheqje...(neni 160, pika 2 "dh")".

15.9.5 Dhënia e dorëheqjes në këtë rast sjell si pasojë deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit nga Këshilli (neni 65 pika 2) dhe pasqyrimin në dosjen personale të magjistratit që krijohet dhe administrohet nga këshillat respektivë sipas nenit 38 të ligjit.

16. Nisur nga rrethanat e paraqitjes së dorëheqjes nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe pasoja e rëndësishme që ky akt (dorëheqja) passjell në procedurën e rivlerësimit kalimtar (ndërprerja/pushimi), nuk rezulton që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të ketë hetuar, analizuar dhe argumentuar nqs në rastin e subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla, organet kushtetuese përgjegjëse kanë administruar dhe disponuar me vendimin përkatës mbi dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit nga statusi i magjistratit.

17. Nisur nga fakti se në momentin e marrjes së vendimit nr.02, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ende nuk janë ngritur Këshillat e lartpërmendur, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit duhej të analizonte dhe të verifikonte zbatimin e procedurës së parashikuar në ligj për periudhën kalimtare, sikundër pasqyrohet më lart.

18. Sa më sipër, rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vlerësuar *a priori* si gjëndje juridike, vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e aktit të njëanshëm të dorëheqjes të subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla, pa analizuar situatën ligjore dhe pa e mbështetur në ligj e prova konstatimin e nevojshëm nëse ky akt (dorëheqja) është administruar dhe nëse është disponuar me vendim mbi të nga organi përkatës, sipas parashikimeve të ligjit nr.96/2016.



19. Në interpretim të nenit G të Kushtetutës, dispozitive të ligjit nr.84/2016 dhe nr.96/2016, nuk është në kompetencë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të disponojë mbi deklarinin e dorëheqjes nga statusi i magjistratit nga ana e subjekteve të rivlerësimit e për më tepër të ndërpresë procesin e rivlerësimit, pa administruar aktin përkatës të organit kompetent ligjor, që shqyrton heqjen dorë nga statusi i magjistratit dhe merr vendimin përkatës.

20. Në të kundërt, situata ligjore mund të paraqitet e tillë që subjekti gëzon ende ligjërisht statusin e magjistratit dhe dorëheqja e tij mbetet e padeklaruar dhe e paformalizuar sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

21. Në këtë drejtim, trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet të kishte kërkuar informacione shtesë apo të ndërmerre procedurat e nevojshme, duke bashkëpunuar me organet e sipërcituara, për të garantuar provat për procesin e vendimmarrjes.

22. Ligji nr.96/2016 e ka të shprehur qartë mënyrën deklarative të miratimit të dorëheqjes nga statusi i magjistratit nga ana e organeve përkatëse, por nuk rezulton që për mungesën e këtij vendimi të jetë hetuar apo të jetë kërkuar administrimi i tij nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikuar.


23. Vetëm pas administrimit të vendimit përkatës të organeve të lartpërmendura për deklarinin e mbarimit të statusit të magjistratit për z Adriatik Llalla, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të kalonte në vendimmarrje, për të rregulluar pasojën e dorëheqjes, që në rastin konkret do të jetë ndërprerja e procesit të rivlerësimit.

24. Për analogji me rastin në shqyrtim, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr.84/2016, praktika ka dhe raste të tjera të deklarinimit të mbarimit të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes.

25. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit duhet të kishte mbajtur në konsideratë dhe analizuar dy raste të ngjashme, kur gjyqtarët kanë dhënë dorëheqjen nga statusi i magjistratit, bazuar në nenin 56 të ligjit nr.84/2016, brenda afatit kohor përkatës, duke e paraqitur atë pranë Presidentit të Republikës, i cili e ka pasqyruar në faqjen e tij zyrtare të internetit. Mbarimi i statusit të magjistratit në të dy rastet është deklaruar me vendim nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, mbështetur në gërmën “ë” të pikës 1 të nenit 160 të ligjit.

26. Më konkretisht në rastin e gjyqtarëve I. Ç dhe I. P, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka marrë përkatësisht vendimin nr.17 datë 10.02.2017 “Për mbarimin e statusit për shkak dorëheqje të gjyqtarit z. I. Ç” si dhe vendimin nr.18, datë 10.02.2017 “Për deklarinin e mbarimit të statusit për shkak dorëheqje të gjyqtarit I. P”.

27. Përfundimisht, përsa u trajtua më lart në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit z Adriatik Llalla, tipologjinë specifike të këtij rasti, ka qenë detyrim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të bënte analizën e kërkuar faktike dhe ligjore me qëllim



verifikimin e rrethanave të domosdoshme juridike për të vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, detyrim ky që në gjykimin tonë nuk është përmbushur.

III.B

28. Në kuadër të analizimit të natyrës së dispozitivit që merr institucioni përkatës i rivlerësimit në rastet e paraqitjes së dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit, jemi të mendimit se Kolegji i Posaçëm i Apelit, edhe në rastin konkret, duhet të marr në analizë e të shprehet në lidhje me materializimin e pasqyrimin në vendimarrjen e institucioneve të rivlerësimit ndalimi i subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar për 15 vite në sistemin e drejtësisë, sipas pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.


29. Në vendimin nr.02, datë 16.02.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasqyrimin e ndalimit që parashikon paragrafi i dytë i Nenit G të Kushtetutës, konstatohet se e ka bërë pjesë vetëm të pjesës arsyetuese të këtij vendimi.

29.1 Konstatojmë se Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016 nuk i njeh në mënyrë të shprehur të drejtën Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të vendosur si pjesë të dispozitivit të vendimit të saj parashikimin e pikës 2 të nenit G të Kushtetutës.

29.2 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit si organi i parë përgjegjës për rivlerësimin kalimtar, mund të shprehet vetëm për atë që ligji nr.84/2016 e lejon, pra sipas nenit 56 apo sipas nenit 58 pika 1.

29.3 Kompetencën e emërimit, rrjedhimisht edhe atë të ndalimit të emërimit për magistratët, Kushtetua ia njeh dy organeve të ngritura për këtë qëllim, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Nisur nga argumenti i trajtuar më lart në këtë ankim, mendojmë se pjesë e vendimarrjes së këtyre organeve kushtetuese që deklarojnë mbarimin e mandatit të magistratit për efekt të nenit G të Kushtetutës, do të duhej të ishte dhe ndalimi i parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni.

29.4 Në këtë kuptim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të shprehet vetëm mbi ecurinë e procesit të rivlerësimit, pra për rastin konkret të përfundimit të tij si shkak dorëheqje në zbatim të nenit G pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, por do të duhej të kishte hetuar, identifikuar dhe arsyetuar dhe mbi aktin që materializon ndalimin e parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit G të Kushtetutës.



III.C

30. Mbi natyrën procedurale të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

30.1 Siç vlerësuam edhe në rrethanat e çështjes, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në marrjen e vendimit nr.02, datë 16.02.2018, ka gjykuar mbi bazë dokumentesh, gjykim i cili *prima facia* nuk parashikohet shprehimisht nga neni 55 pika 5 dhe 6 e ligjit organik të saj, ku parashikohet se “...bisedimet për marrjen e vendimit.. zhvillohen me dyer të mbyllura në praninë e vëzhguesve ndërkombëtar dhe se vendimi i KPK shpallet në fund të seancës dëgjimore.”

30.2 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në rastin konkret ka vendosur vetem mbi bazë dokumentesh, pa zhvilluar një seancë dëgjimore me praninë e subjekteve, që legjitimohen për t’ u thirrur sipas parashikimeve të ligjit nr.84/2016.

30.3 Kjo lloj vendimmarrje mund të konsiderohet e drejtë dhe në respekt të parimit “*për ekonomi në procedurat vendimmarrëse*” dhe thjeshtimit të procedurave për çështje të cilat nuk ka nevojë thirrja e një seance dëgjimore apo ndërrmarrjen e veprimeve të tjera shtesë në ndihmë të vendimmarrjes.

30.4 Për analogji me praktikën, referuar legjislacionit në fuqi, shqyrtimi i çështjeve mbi bazë dokumentesh/aktesh e gjejmë në ligjin nr.49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative*”, ku në nenin 3 “Parimet e gjyimit administrativ” shprehet se “*gjykata...shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi*”.

30.5 Megjithatë, ndryshe nga sa përmban neni 65/1 i ligjit nr.84/2016 për mënyrën e zhvillimit të procesit gjyqësor në Kolegjin e Apelit, në rastin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk gjejmë një dispozitë të posacme që të materializojë parimin e shprehur në nenin 3 të ligjit nr.49/2012.

IV. Kërkimi i ankimit

31. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit 66/2 i ligjit nr.84/2016, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, vendim nr.21/2010, paragrafi 16: “[...]16. Gjykata thekson se nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet



publike dhe gjykatat. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (shih vendimin nr.5, datë 7.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata thekson se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një ratio decidendi, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.06.2009). Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese.”, jemi të mendimit se përsa kohë në këtë ankim ngrihen shkaqe që lidhen me interpretimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese do t’ i shërbente unifikimit të procedurave në të ardhmen në trajtimin e situatave të ngjashme.

32. Në këto kushte, në cilësinë e Komisionerit Publik, bazuar në dispozitën e shkronjës “c”, pika 1 e nenit 66 të ligjit nr.84/2016, kërkoj:

-Prishjen e vendimit nr.02, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin Adriatik Llalla.

KOMISIONERI PUBLIK


Florian BALLHYSA

